


**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**



**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës  
Z/znj \_\_\_\_\_

Në bazë të dispozitave te nenit 44.1 pika Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe  
në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

**F T O J**

Mbledhjen e njëmbëdhjet të rregulltë të K.K-sës, e cila do të mbahet më **29.11.2018**  
(e enjte ) duke filluar në ora **11:00**.

**R e n d i i d i t è s**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Raporti i DUK-së pér punën e deritanishme të komisionit pér emrimin e rrugëve në teritorin e Komunës së Novobërdës;
3. Raportim rrith ndarjes të ndihmes financiare në vlerë prej 5,000€ pér fermerët e dëmtuar nga vjedhjet të Komunës së Novobërdë, (në bazë të kërkesës së komitetit pér komunitete);
4. Aprovimi i propozim rregullores mbi tatimin në pronë pér vitin 2019;
5. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 19.11.2018  
Në: Novobërdë



**Nebojsa Arsic**  
**Kryesues i Kuvendit**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e dhjetë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 31.10.2018, duke filluar në orën 11.00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, Nënkyetari për Komunitete Bajrush Ymeri, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Predrag Stojkovic, Negovan Jovanovic, Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Xhejlane Behluli, Abdyl Gashi, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, Drejtori i Administrates Driton Abdyli, Drejtori i Inspeksionit Xhevati Mehmeti, Drejtori i Urbanizmit dhe Katastrit Bojan Peric përfaqësuesi i OSBE-es, perfaqësuesit e KFORIT, zyrtarë Komunal si dhe një numër i qytetarëve.

Kryesuesi Nebojsa Arsic pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit 13 gjithësej dhe kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

**R e n d d i t e**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Prurja e vendimit për vendosja e mbishkrimeve në ndërtesën e Komunës dhe hapsirave zyrtare;
3. Prurja e vendimit për emrimin e komisionit për ndrimin e statutit të komunës së Novobërdës;
4. Raporti financiarë për periudhën tre mujore 2018 (Korrik-Shtatorë).
5. Raporti i Drejtoris së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollorë 2018/19;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen më këtë rend ditë apo keni ndonjë propozim ose diskutim?.

Zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti pasi përshëndeti të pranishmit tha: unë si zv.Kryesues propozoj që pika 2 dhe 3 të tërhoqet nga rendi i ditës për arsy se i shoh të panevojshme, ne e kemi statutin e Komunës i cili është valid, ju faleminderit.

Nënkyetari për komunitete Bajrush Ymeri pasi përshëndeti të pranishmit tha: mendoj që pika e dytë nga rendi i ditës të tërhoqet, kur e them këtë i kam arsyet e mia. E para e keni fut këtë pikë në rend ditë ndryshimin e statutit meqense nuk është duhur të jetë ndryshimi i statutit por do të duhej të ishte propozimi për ndryshime nese ka ndonjë nen që është në kundershtim me ligjin përndryshe statuti nuk ka nevoj me u ndryshu dhe pasi që pika e tretë është ndryshimi i statutit mendoj se pika e dytë nuk duhet të jetë për arsy se mbishkrimet në ndërtesë të Komunës, simbolet, të gjitha janë të percaktuara me statut prandaj mendoj se pika e dytë nga rendi i ditës duhet të tërhoqet pasi që mbishkrimet duhet të janë të harmonizuara me statutin e Komunës pasi që statuti është akti më i lartë i Komunës ku janë të percaktuara

## Procesverbali i Kuvendit

edhe mbishkrimet, simbolet e Komunës, gjuhët. E dyta është se këto mbishkrime të cilat i kemi vendosur para nëntë viteve i kemi vendosur duke bërë një konsultim gjithëpërfshirës, ka qenë një projekt me OSBE-n, OSBE-ja është këtu që 21 vite dhe është për ti promovuar të drejtat e njeriut, të drejtat e komuniteteve dhe na kan mbeshtetur në këtë projekt për mbishkrime të Komunës dhe i kemi vendosur, natyrisht që nuk jan që nuk ndryshohen por ne nuk kemi pasur konsultime rrëth kësaj pike për ndryshim. Unë jam Nënkyetar për komunitete, përfaqësoj komunitetin Shqiptarë dhe Rom dhe unë asnë konsultim nuk e kam pasur se çka do të ndryshohet me këtë mbishkrime, çka vendoset në këtë mbishkrime, andaj po kërkoj nga ju zt.Kryesues dhe nga antarët e Kuvendit mirëkuptim që kjo pikë e rendit të ditës të tërhiqet nga kjo mbledhje të kem konsultime dhe pastaj të kemi një propozim që të jetë i pranueshëm nga të gjithë antarët e Kuvendit, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: i kemi dëgjuar propozimet që pika 2 dhe 3 të tërhiqet, edhe unë kërkoj që paraprakisht të kemi konsultime dhe as në KPF nuk kemi pasur ndonjë formë se si duken ato mbishkrime, ndërsa sa i përket pikës së tretë mendoj se nuk është e fomular mirë pasi që më mirë kishte me qenë përshtatja e statutit me ligjet në fuqi, pra kemi propozim qe pika 2 dhe 3 të tërhiqet nga rendi i ditës e hudhi në votim, kush është për tërheqje të këtyre dy pikave?

Me 10 vota për, 2 apstenim, 1 nuk ka votuar tërhiqen nga rendi i ditës pika 2 dhe 3.

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Predrag Stojkovic pasi përhendeti të pranishmit tha: pasi që procesverbalı duhet të jetë i besueshëm dhe e gjitha që diskutohet të shkruhet në pjesën kur është shkruar emrimi i antarëve unë nuk kam qenë këtu , e di se në mbledhjen e kaluar kam qenë prezent por ndoshta është ndonjë gabim teknik,por e përsëris që kam qen prezent dhe të pjesa kur kam diskutuar për buxhetin nuk është e gjitha dhe kërkoj që te ceket e gjitha ajo që kam diskutuar, atë që kam diskutuar ne mbledhjen e kaluar e them dhe tash qe ne si Kuvend nuk mundë të jemi propozues të buxhetit por ne vetem mundë të aprovojmë,ndryshimet ne buxhet kerkohen nga Kryetari i Komunës ju Zt.Kryesues keni mundur te kerkoni ne mbledhjen e shtatorit ndryshimet në propozim buxhet nese ju konsideroni se a keni qenë të drejt apo nuk kemi qenë të drejtë duhet të kërkoni këshilla në MAPL, se a kemi të drejt të jemi propozues të buxhetit dhe ta ndryshojm buxhetin ashtu si dëshirojm ne duhet të dim që buxhetin e nënshkruan Kryetari i Komunës e jo ne, ne i kemi kaluar kompetencat tona në Kuvend ky është mendimi im, nuk është më rëndësi që ti kem vetem 8 vota për me marr një vendim por është përgjegjësi që gjithqka që punojm të jetë në harmoni me ligjin.

Kryesuesi tha: A keni ndonjë vërejtje tjeter në procesverbal?, ne çdo vendim që marrim në Kuvend e dergojm në Ministri për verifikim.

Predrag Stojkovic tha: ju e propozuat rendin e ditës dhe menjëher u tërhoqen dy pika nga rendi i ditës a jeni duke punuar seriozisht?

Kryesuesi tha: propozimet ishin nga zt.Ramush Mehmeti dhe zt.Bajrush Ymeri për tërheqje të këtyre pikave.

Predrag Stojkovic: unë po kërkoj që në procesverbalin e ardhshëm të ceket ajo që kam diskutuar në mbledhjen e kaluar, faleminderit.

Nga procesverbali i mbledhjes së kaluar kur është diskutuar lidhur me aprovimin e buxhetit Predrag Stojkovic ka thënë: mendoj se Kryesusi është duhur të konsultohet me Ministrin paraprakishtë, nese e shikon Ligjin për Vetqeverisje Lokale neni 40 se cilat jan kompetencat tona është edhe miratimi i buxhetit dhe planeve investuese, neni 58 të per gjegjësit e Kryetarit, shkronja i) Kryetari i Komunës propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvend, unë mendoj se neni 58 dhe pika i janë shumë të qart, ne kemi ligj dhe këtë duhet ta respektojm, pra ligji është shumë i qartë që buxheti duhet të jetë në pajtueshmeri më Kryetarin e Komunës dhe ne duhet të votojm nese e pranojm apo jo, e jo ta ndryshojm dhe pa pëlqimin e Kryetarit nuk ka ndryshime, neni 50 se çka ndodh me Kuvendin në situata të caktuara, shkronja c thot nese nuk nuk miratohet buxheti në periudh të caktuar ligjore Kuvendi është jo funksional. Unë mendoj se

## Procesverbali i Kuvendit

ne nuk kemi të drejt ta ndryshojm buxhetin vetem se me konsultim me Kryetarin e Komunës dhe këtë kemi mundur ta bëjme më heret por nuk kemi bashkpunuar me kohë, është edhe një gjë tjetër me rëndësi që çdo projekt që do të realizohet do te vij në kuvend dhe ne do të votojm për ato projekte.

Ju lutem shikoni edhe njëherë nenin 58 fjala e par aty shkruan se Kryetari e propozon sa i përket të përgjegjësit e Kryetarit te shkronja i propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim ne Kuvendin e Komunes dhe egzekuton buxhetin e miratuar, ndërsa neni 40 kush e miraton buxhetin, unë po flas në bazë të ligjit e ju vazhdoni por une po pyes ne a jemi duke e propozuar buxhetin apo duke e aprovuar, ndërsa përgjigjia është se ne vetem e votojm, fjala propozim dhe miratim kanë dallim dhe dallimi është shumë i madh. Ne kemi pasur pesë muaj kohë për të propozuar dhe analizuar buxhetin dhe kemi pasur mundësin më heret për ti ndryshuar këto projekte duke u konsultuar me Kryetarin e Komunes, por kjo është pernjegjësi e juaja Kryesues unë vetem të njoftova se kush e propozon e kush e aprovon buxhetin, ne skem të drejt ta ndryshojm buxhetin.

Pasi nuk pat vërejtje tjera proceverbali u votua me 12 vota për, 1 nuk ka votuar nga antarët prezent të Kuvendit.

**Pika e dytë:** Raporti financiarë për periudhën tre mujore 2018 (Korik-Shtatorë).

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalen Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi përshendetë të pranishmit tha: me material e keni marrë raportin financiar pë tremujorin e tretë 2018, do ti paraqes disa të dhëna për këtë periudhë, e keni të hyrat vetanake pë tremujorshin e tretë të cilat në total janë 51,081.97€, me radh i keni në tabel të hyrat nga tatimi në pronë 15,704.15€, të hyrat nga regjistrimi i automjeteve 5,150.00€ dhe të hyrat e tjera i keni të paraqitura që mos ti ceki secilen veç e veç, në faqen tjeter e kemi tabelen e shpenzimeve për paga dhe meditje kanë qenë të planifikuara 472,360.50€ kurse janë shpenzuar 463,494.70€, përmallra dhe sherbime janë shpenzuar 51,054.62€, për shpenzime komunale janë shpenzuar 13,332.30€, për subvencione janë shpenzuar 2,516.50€ dhe për investime kapitale janë shpenzuar 127,755.28€ i keni tabelat edhe për secilen zyre veç e veç unë kaq kisha nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu pasi përshendetë të pranishmit tha: ne si tri subjekte politike PDK, AKR dhe VV i kemi disa vërejtje rreth këti rapporti i cili nuk është në rregull pasi që të përbënbaruesi privat janë shpenzuar rreth 12% e buxhetit Komunal për përbënbaruesin privat, kjo dukuri po vazhdon të përseritet çdo tremujorë dhe për mendimin tim kjo është keqmenaxhim i financave në Komunën tonë, nese ka mundësi me na sqaru se për çfarë arsy është ky keqmenaxhim, ju faleminderit.

Abdyl Gashi pasi përshendetë të pranishmit tha: Kuvendi nuk po përfillet duke filluar prej komisioneve të cilat janë formuar prej këtij Kuvendi ku ka të bëjë me buxhet dhe financa te furnizimi me lop 4320€, nese ju kujtohet këtu është prezantuar një komision dhe është vendosur për ti verifikuar familjarët të cilët janë dëmtuar nga vjedhjet e fundit të bagëtive dhe asnjëher unë si antarë i këtij komisioni nuk jamë thirrë dhe nuk jam pyet për asgjë, por kjo qështje ka kaluar në heshtje dhe nuk dihet se kujt i janë dërguar këto mjete, sa mjete u janë ndarë këtyre familjarëve dhe kjo shumë mbetet vetem në leter dhe nuk është bërë asgjë më shumë, andaj ne këtë do ta procedojm deri në fund pasi që kam qenë antarë i komisionit dhe në mënyrë që mos të përseritet një praktik e till do të kërkoj edhe prej organeve të drejtësisë që njëherë e përgjithmon të mos ndodhin shkelje të tillë, edhe të qiraja nga prona publike është 0, a është e vertet që Komuna nuk ka asnjë pronë që shfrytëzohet dhe e ka me qira dhe kjo po mendoj që nuk është e vërtet por është një neglizhenc, një mospernjegjësi apo një marrëveshje e cila ipen pronat e Komunës së Artanës dhe nuk figurajn mjetet të cilat mblidhen nga qiraja, ju faleminderit.

Xhejlane Behluli pasi përshendetë të pranishmit tha: para se të vij materiali për Kuvend i kam dhënë disa kritika në KPF ku spo mirren parasysh është i paqartë këtu ni term pasi nuk është i përkthyer, dhe kur të flasim në KPF kisha kërkua të mirren parasysh dhe të përmirsohen, të njejten kohë jam ankuar disa herë

## Procesverbali i Kuvendit

pasi jamë e paknaqur sa i përket drejtshkrimit pasi që këto dokumente mbisin në arkiv të Kuvendit, ju faleminderit.

Zv.Kryesuesi tha: mendoj se në raportin financar të tremujorit të tretë po mungon planifikimi, pasi që ne si antarë të Kuvendit duhet të dimë se sa janë planifikuar për inkasim për këtë tremujorë nga të hyrat e tatimit në pronë dhe në bazë të planifikimit se sa kanë arritë rezultat. Të nderuar antarë të Kuvendit paramandoni për 9 mësuesit e parë janë marrë 38,186€ është shumë marramendese për një buxhet kaq të vogël dhe askush të mos jep llogari është apsurde të mirret kjo shumë nga përmbaruesi, të regjistrimi i automjeteve është taksë në vlerë prej 10 € që e merrë Komuna, ndërsa ne deri më tanë i kemi të inkasuara 10,635€ kjo vlerë prej 5€ si po del nese taksa është në vlerë prej 10€, përsosurisht më bënë të dyshoj pasi që ose është shumë e madhe e prezantuar ose është e pasaktë, sa i përket te qiraja e pronave publike ne e dimë që është dhënë tokë në koncesion ka pasur kontrata ka pasur komision që ka punuar në atë drejtim ka pasur kontrata dhe në tremujorin e parë ka pasur 0 inksaim, në tremujorin e dytë 1,170€ dhe ne tremujorin e tretë perseri 0 inkasim. Të nderuar koleg si antarë i Kuvendi kërkoj që mos të votojm një raport të tillë, të kërkojm svarime shtesë sidomos për pikën e inkasimit të buxhetit nga përmbaruesi privat, gjithashtu pajtohem plotësisht kur Abdyl Gashi thotë se Kuvendi Komunal ka marrë vendim për ndarje të 5,000€ buxhet për vjedhje të kafsheve dhe ne si Kuvendi Komunal të mos diem se ku kan shkuar këto mjete, andaj kërkoj që unanimisht të votojm kundër këtij raporti që ky raport të mos kaloj, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: ti per gjigjëm Selatinit për përmbaruesin privat janë disa firma të cilat më herët i kanë kryer punët dhe nuk kan pritur deri sa ti bëhet pagesa dhe e kanë dorzuar lënden të përmbaruesi, sa i përket furnizimit më kafsh vetem janë ndarë mjete por ende nuk nuk është bërë kompenzimi ndaj qytetarëve që janë dëmtuar nga vjedhjet, ndërsa te qiraja publike është 0 por Drejtoresha i ka kontratat dhe sigurisht që ka disa që nuk i kanë kryer ende pagesat, ju faleminderit.

Selatin Nuhiu tha: i nderuari Drejtor, përmbaruesi nuk mundet mi marrë paret nese ju i përbaheni afateve ligjore të pagesave, ju faleminderit.

Pasi nuk pat diskutime tjera me 4 vota për, 8 kunder( Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Mirjana Simijonivic, Dragana Dimic, Dobrivoje Djordjevic, Ivica Cenic) dhe 1 apstenim nga antarët e Kuvendit nuk aprovohet Raporti Financiar për tremujorin e tretë për vitin 2018.

**Pika e tretë:** Raporti i Drejtoris së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollorë 2018/19;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalen Zyrtarit për Arsim Flamur Uka.

Flamur Uka pasi përshendetë të pranishmit tha: pasi që raporti është kërkuar në KPF ne e kemi dorëzuar pak me vonesë, këtë raport e kam përpiluar unë dhe po besoj që keni pasur pak kohë ta analizoni pasi që nuk ka pasur shumë material vetem janë disa të dhëna për fillimin e vitit shkollorë 2018/19, nuk e kisha lexuar tërsishtë por nese keni ndonjë pyetje do të mundohet tju per gjigjëm, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Zv.Kryesuesi tha: zt.Kryesues ne kemi thënë edhe më herët që në Kuvend nuk kanë nevoj me raportu zyrtarët Komunal janë Drejtorët e Drejtorive Komunale, Kryetari i Komunës është obligativ që brenda një muaji ti emëron Drejtoritë Komunale dhe ti prezantoj para Kuvendit, kemi informata për Drejtorin e Bujqësisë se është në listë të pagave dhe nuk vjen për të punuar fare dhe kjo është shkelja më e rënd, prandaj e para është se ky raport nuk është i nënshkruar dhe nuk po e fajtësoj zyrtarin pasi që ka qenë në pushim dhe është duke u bërë presion i madhë ndaj punëtorëve, andaj nese nuk është Drejtori për të raportuar nuk duhet pranuar raportin pasi që kjo është hajgare me Kuvendin, ju faleminderit.

Selatin Nuhiu tha: unë si propozues i kësaj pike propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhëshme pasi që materiali na ka ardhur sot kur e fillua mbledhjen dhe ne kërkoj që Drejtori i Arsimit të jetë prezent dhe të raportoj, ju faleminderit.

## Procesverbali i Kuvendit

Abdyl Gashi tha: ky rapport i Drejtorisë së Arsimit është pak i ngutshum për arsy se nuk saktëson as shumën e mjeteve të cilat janë siguruar për ngrohje dhe as shumën e mjetev të cilat sigurohen për higjenë dhe materiale tjera të cilat i duhen një shkolle dhe mendoj se ne senacen e ardhshme të vij Drejtori dhe të raportoj në lidhje me këtë, ju faleminderit.

Pika e katërt : Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli tha: kisha kërku të diskutojm për komitetin për komunitete pasi i kam lexuar procesverbalet në web faqe të Komunës dhe asnë pikë e rendit të dites nuk vjen në Kuvend, kemi përfaqësues edhe të Kuvendit që janë në komitete dhe nuk e ngritin zërin, por nuk të kishet takuar të ishe zv.Kryesues sikur mos të ishte 10% që na takon si komunitet Shqiptarë andaj kisha kërku që të keni bashkëpunim me komitetin për komunitete dhe me Nenkrytarin për komunitete në mënyrë që të diem se për çfarë jemi këtu pasi që në tjerë qytete ku nuk ka minoritete nuk ka fare zv.Kryesues, ju faleminderit.

Zv.Kryesuesi tha: po më vjen mirë për pytjen por Kryesuesja e komitetit është e zgjedhur dhe është obligative ti propozoj pikat dhe nese Kryesusi voton kunder është shumica që e aprovon, andaj Kryesuesja e komitetit mundet të merrë pjesë në çdo seancë dhe ka mundësi për propozime konkrete, unë personalishtë nuk kamë pasur informat se kur është mbajtur komiteti për komunitete është edhe neglizhenc e imja nuk po e fajtësoj askënd por po pajtohem që duhet të bashkpunojmë. Sa i përket pikës të ndryshme unë e kam një propozim zt.Kryesues, te nderuar antarë të Kuvendit, të nderuar qytetarë po e shohim gjendjen e cila është në Komunën tonë, në vitin 2012 është aprovuar rregullorja për ndarje të subvencioneve 01/2086 me këtë rregullore neni 6 dhe 9 Kryetari ka të drejtë të ndaj buxhet për persona juridik deri në 1,000€ vlerë dhe për persona fizik deri në 500€ vlerë, por sipas nenit 6 pika 3 Kryetari është obligativ që për çdo 6muaj të raportoj në Kuvend për çdo cent të shpenzuar në subvencione por një gjë e till nuk ka ndodhur, andaj unë sot e kam një propozim konkret që Kuvendi tja merr të drejten Kryetarit të Komunës që Kryetari i Komunës të mos ketë të drejtë të shpenzoj asnë cent pa vendim të Kuvendit Komunal, çdo qytetarë ka të drejt të bëjë kérkesë, kanë nevoj për ndihma, të propozohen dhe të bihen në komision në Kuvend dhe të dihet se kujt po i ndahen këto subvencione, andaj në bazë të kësaj rregullore unë propozoj që Kuvendi sot të merr një vendim ku thotë se Kryetarit të Komunës i mirret e drejta për ndarje të subvencioneve, ju faleminderit.

Predrag Stojkovic tha: nuk e kam te qart qfarë keni bërë me pikën e kaluar te rendit te dites, a e kini kaluar apo terhiqe nga rendi i dites, a kemi votuar a jo, rapporti eshte lexuar po nuk është aprovuar. Ju jeni duke folur me qendrime sikur keni ju të drejt po duhet te bazoheni ne ligjin për vetqeverisje lokale ne nenin 47 pika 1 ku thot se ju jeni përgjegjës që rendin e dites ta caktoni me kryetarin e Komunes, kam dashur te them se për dy pikat e para duhet të konsultoheni me përfaqësuesit e asambles komunale ku kemi ardhur ne situat ti terheqim tri pika të rendit të dites, a e shikon ju se Kuvendi duhet ti merr punët me seriozisht ti kryej punet e veta apo ne duhet te jemi ketu vetem sa për ti marr meditjet dhe ne të jemi ketu sa per ti terhek pikat në rend të dites dhe te aprovohet vetem procesverbali.

Kryesuesi tha: këto dy pika janë tërhequr me propozim të zv.Kryesuesit Ramush Mehmeti dhe Nenkrytarit për Komunitete Bajrush Ymeri.

Predrag Stojkovic tha: kjo pyetje ishte pse pikat e rendit të dites janë vendosur pa u konsultuar dhe tash tërhiqen jo pse jan votuar a jo, ne qfar drejtimi janë vendosur apo propozuar, qka duhet te ndryshojm dhe qka duhet të shtojm mos të vendoset në rend të dites nese nuk është për tu diskutuar.

Zv.Kryesuesi tha: një gjë është e qartë pasi që Kryetari i Komunës nuk po deshiron me bashkëpunu me Kuvend, une e di se i është dërguar e-maili Kryetarit të Komunës për agjend, mbajtje të seances se KPF dhe Kuvendit dhe nese ka pika për të propozuar për rend dite prej Kryetarit dhe Drejtorive Komunale dhe si mundemi ne të bashkpunojmë me një Kryetar që nuk bashkunon me Kuvend, prandaj ne duhet të jemi realisata dhe duhet të diem që ligjet janë për të gjithë njësoj, Kuvendi ka formuar një komision për ndarje të subvencioneve dhe Drejtori vetem thotë se janë ndar mjete por ende nuk janë bler kafshët dhe nuk e di se çfarë po presin, andaj zt.Kryesues kërkoj nga ju që propozimin tim ta hudhni në votim nese

kalon mirë e dërgojm në MAPL dhe MAPL na njofton se a kemi vepruar apo jo në harmoni me ligjin. Kjo Komuna ka punuar edhe në të kaluaren punon tash dhe do të punoj edhe në të ardhmen pa dallime etnie dhe duhet të punoj për të mirën e gjithë qytetarëve e jo vetem të një individi, nuk e di se çfarë Kryetari i Komunës është kur që 1 vit nuk i prezanton Drejtorat dhe është shkelje e ligjit që Drejtori të zgjedhet këtu e të jetoj në Serbi, ju faleminderit.

Xhejlane Behluli tha: vetem të kisha lut ty Kryesues me kry detyren tënde pasi që nuk po dihet në këtë rast se a është Kryesues i nderuari Ramush Mehmeti apo ju, nuk kam asgjë kunder por tkisha lut me marrë vendime vet pasi që ju e përfaqësoni këtë Kuvend, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: une nuk i bi vendimet po antarët e Kuvendit votojn për pruarje të vendimeve.

Driton Abdyli Drejtor i Administratës pasi pëershendeti të pranishmit tha: nuk e di se çfarë praktike është kur një pikë e rendit të dites tërhiqet dhe mandej i bie dikujt ndër mendë të flasë, nese dikujt ju kujtua tash të flas do të flasë edhe unë dhe një gjë ta keni parasysh se unë kamë qenë edhe në KPF dhe pikat të cilat i ka propozuar Kryetari i Komunës unë i kam propozuar që të shkojnë në Kuvend dhe e dyta është se ju keni bërë një shkelje procedurale pasi që nuk votohet përnjëher për dy pika që të tërhiqen por së pari propozohet njëra pikë që të tërhiqet e pastaj tjetra dhe e treta atë që e tha Nënkrytari i Komunës e ka thënë në bazë të përvojes dhe askush nuk ka nevoj të flasë pasi që nuk i frigohem askujt dhe ju kisha lut të gjithëve pasi që puna duhet të kryhet profesionalishtë mirë dhe ajo që duhet me u fol duhet të diskutohet dhe ajo që duhet të konsultohet duhet të konsultohet e me i dhei zjarr punës kjo ndodh vetem te ne. Një gjë të ju tregoj, nuk po e kërcënoj askënd por nderin tim dhe të familjes e kam rujtur edhe para luftes edhe gjatë luftë edhe pas luftës dhe nuk lejoj mem shkel askush, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: kur kam propozuar rendin e ditës kam pyetur se a ka ndonjë plotësim propozim dhe kemi pasur kërkesa që të tërhiqen dy pika dhe nuk e di se kush të ka ofenduar.

Predrag Stojkovic tha: keni tërhequr tri pika nga rendi i ditës, raporti i drejtorisë së arsimit nuk është përtu aprovuar është vetëm përtu diskutuar.

Kryesuesi tha: Z. Nuhiu ka kërkuar të jet përsëri ne mbledhjen e ardhshme.

Predrag Stojkovic tha: tash mos të debatojna rrëth rendit të ditës edhe pse drejtori nuk është prezent kemi mundësi me diskutu.

Bajrush Ymeri tha: zt.Kryesues përt ta sqaruar edhe njëher këtë debatë që u nxit përsëri edhe pse mendoj se u kry, unë nuk kam kërkuar që të tërhiqet pika e tretë nga rendi i ditës për arsy se e kam parë një shkresë që ka ardhur nga Ministria dhe meqë KPF me statutin tonë të vitit 2010 ka qenë në përbërje prej 7 antarëve ndërsa në Udhëzimet Administartive që kanë pësuar më vonë nga Ministria e Pushtetit Lokal na ka anuluar vendimin prej 7 antarvë që kemi formuar ne dhe është duhur ta formojm KPF me 5 antarë dhe pikërishtë kjo ka qenë një pikë që është duhur të mirret vendimi që të ndryshohet statuti. Unë kam kërkuar që të tërhiqet pika e dytë pasi që nuk kemi pasur konsultime, e thash edhe më herët se mbishkrimet nuk janë diçka të paprekshme por duhet të kemi konsultime me të gjithë që kur të vijë në Kuvend tëjenë të pranueshme nga të gjithë kjo ka qenë kërkesë e imja. Sa i përket pytjes së Xhejlanit këtë po e them për hirë të saj dhe të OSBE-es pasi që e kam udhëhequr KPF për 4 apo 5 vite, kam qenë Kryetari i kësaj Komune, e kam mbështetur Komitetin për Komunitet dhe në mandatin e dytë si Nënkrytar kam marrë pjesë në shumë takime të organizuara nga OSBE-ja përti ngritisht kapacitetet tona përtë qenë Komiteti për Komunitete sa më profesional dhe janë katër mekanizma shumë të rendesishëm si Nënkryetari për Komunitete, zv.Kryesuesi për Komunitete, Kryetari i Komitetit për Komunitete dhe shefja e zyres Komunale për Komunitete të gjithë këto duhet të bashkpunojnë ngushtë rrëth hartimit të rendit të ditës dhe rrëth angazhimeve tjera. Xhejlanja ka plotësishtë të drejtë, unë kam kërkuar që Kryesuesja e këtij komiteti të ketë një pagë shtesë pasi që me një meditje që i takon asaj nuk mundet me i përcjell të gjitha aktivitetet e Komitetit për Komunitete, ajo duhet të jetë prezente edhe në Kuvend pasi që e përfaqëson Kuvendin, ajo duhet të jetë edhe në mbledhje të KPF-së prandaj kam kërkuar kompenzim shtesë, ju faleminderit.

## Procesverbali i Kuvendit

Ramush Mehmeti tha: sa i përket pikës së Kryesueses së komitetit mendoj se unë shumë i qartë kesh që unë asnjëherë nuk kam marrë pjesë, sa i përket pikave të cilat kaluan çdo antartë i Kuvendit ka të drejt të propozoj dhe Kuvendi është ai që e voton, ishte propozimi im që të tërhiqen dy pika dhe nuk ka asgjë të kunderligjshme, zt Kryesues unë e dhash një propozim dhe kërkoi që të hudhet në votim, ju faleminderit. Kryesuesi tha: sa i përket kësaj rregullore për ndarje të subvencioneve të konsultohemi së pari me Ministrin në mënyr që mos të biem ndonjë vendim të kunderligjshëm.


Abdyl Gashi tha: është problem me parashtru pyetje te të ndryshmet pasi që ne kemi vetem dy Drejtor apo tre prezent në mbledhje, ne e kemi një problem pasi që salla e kultures palestra nuk funksionon për arsyet disa dritave, aty njerëzit paguhën dhe marrin pagë, ne po diskutojm më shumë për dy pika të cilat mendoj se na kanë ardhur si provokim me e nxit situaten mes nesh ku Komuna ka qindra probleme tjera të qytetarve që nuk i bie në Kuvend që ti diskutoj por bjen dy pika që jan provokative dhe nxisin urrejtje mes nesh, ne jemi këtu për të bashkpunuar dhe i falenderoj të gjithë që votuan për tërheqje të këtyre dy pikave provokuese, ju faleminderit.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic  
Kryesues i Kuvendit